



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Maj, 2015

Një ngjarje e veçantë për arsimin e Kosovës
**Sekretari i përgjithshëm i Internacionales Botërore të
Arsimit viziton SBASHK-un**



Në SBASHK është shtuar entuziazmi dhe po punohet me kujdes në përgatitjet për t'i pritur sa më mirë miqtë e vjetër të arsimit të Kosovës. Për mësimdhënësit e Kosovës kjo është një ngjarje e veçantë sepse atyre u vijnë në vizitë pune Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, z. Fred Van Leeuwen, i cili përfaqëson 30 milionë anëtarë në gjithë botën, duke përfshirë edhe Kosovën ... (faqe 5)

SBASHK-u takua me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Kërkohet që Ligjet e aprovuara të zbatohen



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i kishte dërguar më 18 maj një shkresë... (faqe 5)

Takimet informative me anëtarët e SBASHK-ut
nëpër Komunitet e Kosovës
**Përkrahjet angazhimi i SBASHK-ut për
shërbime të reja ndaj anëtarësisë**



Në kuadër të projektit "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave Arsimore", po zhvillohen takime informative... (faqe 7)

Këshilli Shtetëror për
Licencim në shërbim të
cilësisë në arsim
**U debatua lidhur me
licencimin dhe
përformancën e gradimin**
Këshilli Shtetëror për
Licencim, anëtar ... (faqe 6)

Përfaqësuesja e lartë e
GIZ vizitoi Sindikatën tonë
**Ndërkombëtarët
shprehin respekt të
lartë për angazhimet e
SBASHK-ut**
Duke parë angazhimin e
sinqertë e të fuqishëm të
SBASHK-ut ... (faqe 6)

Intervistë me znj. Arta Rudi,
nënkryetare e SUSHK-ut

**Shembull i një femre
aktive në Universitet dhe
Sindikatë**
Arta është aktiviste sindikale
që nga viti 2004, e cila është
nënkryetare ... (faqe 3)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Editorial



Një vit i suksesshëm i gazetës sonë

E filluam në majin e vitit të kaluar punën që përmes gazetës sonë të përbashkët “Arsimimi sot” të jemi sa më afër jush dhe që ta ngrisim cilësinë e komunikimit me anëtarësinë. Doli numri i parë dhe u prit mirë nga lexuesit e shumtë. Redaksia e gazetës po merrte lëvdata, por edhe këshilla. Lexuesit shtonin kërkesat e tyre dhe ne përpiqeshim të ishim në hap me lajmin dhe të informonim drejtë për ngjarjet.

“Arsimimi sot” e ka ditëlindjen e parë. Kjo gazetë jona tani e disa numra me radhë ka marrë formë dhe përmbajtje edhe më të mirë. U bë edhe më e dashur për lexuesit. Duke u këshilluar me miq të SBASHK-ut dhe me ekspertë të gazetarisë, gazeta tani ka rubrika të reja dhe u krijua kështu hapësirë që të prezantohen individë përmes

rubrikës *Intervista* dhe u kemi dhënë hapësirë edhe aktiviteteve nëpër komunat e Kosovës.

Redaksia duke u ndjerë mirë pse gazeta po gjen gjithnjë e më shumë lexues ju fton që ju të nderuar mësimdhënës, anëtarë të SBASHK-ut, të bëheni pjesë e ekipit që përgatit çdo numër dhe këtë mund ta bëni duke na dhënë ide e pse jo, edhe duke shkruar artikuj për aktivitetet dhe sfidat në mesin tuaj.

Ne ju premtojmë se gazetën tonë të përbashkët do ta dizajnojmë ashtu si mendoni ju se është më mirë. Qëllimi ynë është që bashkërisht të jemi sa më të suksesshëm dhe të ofrojmë në faqet e “Arsimimi sot” shkrime e tema që juve ju duken të rëndësishme.

Gëzuar!

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shitesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC “Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore”, SBASHK-u nga **1 marsi 2015** ofron shërbime juridike për anëtarët e vet.

SBASHK-u ka filluar të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet nëpër tërë komunat e Kosovës

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Intervista

Intervistë me znj. Arta Rudi, nënkryetare e SUSHK-ut

Shembull i një femre aktive në Universitet dhe Sindikatë



Arta është aktiviste sindikale që nga viti 2004, e cila është nënkryetare e sindikatës së Universitetit dhe Shkencës së Kosovës (SUSHK). Ajo me punën e saj dhe qëndrimet parimore çdoherë ka bërë që jo vetëm SUSHK-u por edhe SBASHK-u të punojnë për të mirën e anëtarësisë. Është edhe anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, tani në mandatin e dytë dhe çdoherë ishte dhe është zë i fuqishëm i fuqizimit të rolit të femrës në vendimmarrje dhe në sindikatë.

Arsimimi Sot:

1. Kush është Arta Rudi?

Rudi:

E lindur në Komunën e Gjakovës, bashkëshorte, nënë e tre fëmijëve, dhe gjyshe e një mbese të mrekullueshme tani tre muaj.

Titulli profesional: Msc e shkencave të kimisë, e punësuar në njësinë akademike të FSHMN-së, në Departamentin e Kimisë.

Arsimimi Sot:

2. Roli i femrës në Universitet?

Rudi:

Pjesëmarrja e femrës në Universitetin Publik "Hasan Prishtina" është gjithëpërfshirëse, prej femrave-studente, deri të mësimdhënësit dhe shkencëtar-hulumtues, por unë konsiderojë (këtë mund t'a vërtetojnë statistikat e Universitetit), se femrat në numrin total të stafit akademik në Univesitet, kanë një përqindje shumë të ulët. Për të arritur statusin e profesorit, femra ballafaqohet me sfida të mëdha, por si gjithandej në

Institucionet e Republikës së Kosovës, edhe në Universitet, femra shkelë shtigjet e suksesit, dhe mbërrinë aty ku synon. Sot në Universitet femra ka arritë të jetë në pozicionin e një drejtuese të lartë, profesreshë, asistente, laborante, teknike-administrative, përherë e përkushtuar në punë me etikë profesionale dhe integritet të lartë. Por, duhet të punojmë më shumë që pjesmarrja e femrës në vendimmarrje në Universitet të jetë më e lartë, shembull i suksesit në këtë drejtim është kryesia e SUSHK-ut, ku nga nëntë anëtarët e kryesisë tre anëtar janë femra, dhe një femër është nënkryetare, pra këtë shembull duhet t'a përcjellin edhe organet drejtuese të Universitetit.

Arsimimi Sot:

3. Si e sheh Arta pozicionin e femrës në SBASHK?

Rudi:

Nëse prap i referohemi statistikave, numri i femrave të punësuar në arsimin parauniversitar është i lartë, dhe atë shumë më i lartë se ai i meshkujve, por sa përfaqësohen femrat në strukturat e SBASHK-ut?, vlenë për të dëshiruar, sepse femrat si në kryesi po ashtu edhe në këshillin e përgjithshëm është pak e përfaqësuar, dhe mungon ndikimi pozitiv i femrës, posaqërisht në procesin e vendimmarrjes, që në një aspekt bazuar në numrin e anëtarësisë femra, është e diskriminuar në aspektin gjinor.

Arsimimi Sot:

4. Çfarë duhet të bëjë më shumë SBASHK-u për ta forcuar rolin sindikal të femrës?

Rudi:

SBASHK-u, duhet të filloj nga kryesia deri të njësit sindikale të shkollave, të nxis rritjen e përfaqësimit dhe pjesmarrjen e femrës në vendimmarrje, dhe si bazë për llogaritje mundë të shërbejë numri i anëtarëve sindikalist-femra. Kur,

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



në një shkollë më shumë ka anëtarësi sindikale nga gjinia femërore, pse mos të përfaqësohet sindikata e shkollës nga një femër, duke mos diskriminuar gjininë e kundërt, dhe normal kriter të jetë edhe angazhimi, përkushtimi i secilit në rritjen e efikasitetit e dhe efektivitetit të punës në sindikatë. Veprimi i SBASHK-ut, në drejtimin e tillë, do të sillte progres dhe rritje të numrit të anëtarësisë.

Arsimimi Sot:

5. Po të ishit kryetare e SBASHK-ut, cili do të ishte prioriteti juaj i punës?

Rudi:

Tani kjo pyetje është paksa hipotetike, dhe e kundërt më përgjigjet e mia të dhëna më lartë, ku kërkoja që pjesmarrja e femrave në struktura dhe në procesin e vendimmarrjes në SBASHK të rritet, por të mos ju lë pa një përgjigje, kisha preferuar që bile nënkryetare të jetë një femër. Unë, apo cila do femër që do të ishte drejtuese e SBASHK-ut, duhej të kishte prioritet iniciativat e reja, të aplikojë metodologji të re në trajtimin e kërkesave sindikale që burojnë nga baza, të dëgjohet më shumë zëri i femrës, të ketë më shumë transparencë, përgjegjësi dhe llogaridhënie. Të ketë më shumë bashkëpunim dhe dialog me grupet e interesit, me të gjithë aktet që do të ndihmonin në realizimin e kërkesave tona, të jemi të barabartë në proceset dialoguese, që autoriteti i sindikatës të ndikoj në të gjitha proceset, që anëtari i sindikatës të jetë më i mbrojtur, dhe më dinjitoz para punëdhënësit-organëve të caktuara.

Arsimimi Sot:

6 Çka mendoni për shërbimet e SBASHK-ut ndaj anëtarësisë?

Rudi:

Shërbimet e SBASHK-ut, ndaj anëtarësisë po intensifikohen ç'do ditë e më shumë. Ka iniciativa të reja, shembull paisja e anëtarësisë me kartela elektronike të biznesit, ku SBASHK ka arritur marrëveshje me biznesin në interes të anëtarësisë, pastaj janë organizuar trajnime të

ndryshme, por përherë ka vendë dhe hapësire ku shërbimet duhet të zgjerohen dhe të avansohen, duke kërkuar që propozimet për shërbime të merren nga poshtë-lartë, nga vetë baza sindikale, dhe kjo për vetë SBASHK-un, do të nënkuptonte realizim të misionit të saj.

Arsimimi Sot:

7. A duhet ndryshuar diçka në SUSHK?

Rudi:

Mendoj se po, duhet të ndryshohet qëndrimi i anëtarësisë nga radhët e stafit akademik, të cilët janë pjesë e sindikatës, sepse prezenca e tyre në takimet e sindikatës është shumë e rëndësishme në rritjen e besimit në rolin e sindikatës në UP, të jenë më proaktivë, dhe të anëtarësohen ata të cilët nuk janë anëtarë të sindikatës, sepse së bashku jemi më të fortë në realizimin e objektivave sindikaliste. SUSHK-u, duhet të punojë më shumë që delegatët e Kuvendit të përfaqësohen nga një numër më i madh nga radhët e stafit akademik. SUSHK-u, duhet të punojë më shumë me shoqata, ndërsa vetë ka filluar të bëjë reformna brenda kryesisë, ku ka prurje të reja, dhe është rritë numri i anëtarëve. Shpresoj, që me ndihmen e SBASHK-ut, Sindikata e UP-së do të realizon kërkesat legjitime.

Arsimimi Sot:

8. A keni diçka për të shtuar e që ne nuk iu kemi pyetur ?

Rudi:

- apeloj te autoritet drejtuese te UP-së, që veprimtarët sindikal mos të pengohen në punën e tyre, por të mbështeten ashtu siç e kërkon edhe Ligji.
- apeloj te anëtarësia e sindikatës, që të përkrahin të zgjedhurit e tyre, sepse ata punojnë për interesat e anëtarësisë, dhe
- apeloj poashtu të të gjithë punëtorët e arsimit që të anëtarësohen në sindikatë, sepse bashkimi bënë fuqinë.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Sekretari i përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit viziton SBASHK-un



Në SBASHK është shtuar entuziazmi dhe po punohet me kujdes në përgatitjet për t'i prituri sa më mirë miqtë e vjetër të arsimit të Kosovës. Për mësimdhënësit e Kosovës kjo është një ngjarje e veçantë sepse atyre me datë 3 dhe 4 qershor 2015 u vijnë në vizitë pune Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, z. Fred Van Leeuwen, i cili përfaqëson 30 milionë anëtarë në gjithë botën, duke përfshirë edhe Kosovën dhe z.Walter Dresscher nënkryetar i ETUCE (Komiteti i Sindikatave Evropiane të Arsimit) dhe kryetar i AOB-së (Sindikatës së Arsimit të Holandës). Do të jetë ky një moment festiv në SBASHK dhe mundësi e mirë e shprehjes së respektit për punën e madhe që ka bërë në vitet më të vështira për arsimin e Kosovës, z.Fred Van Leeuwen, i cili ishte kthyer në një zë të fuqishëm për Kosovën dhe arsimin tonë dhe kishte mundësuar që përfaqësuesi i SBASHK-ut, dr. Agim Hyseni, në vitin 1993 t'i drejtohej Asamblesë së Përgjithshme të

UNESCO-së me një fjalim duke sensibilizuar gjendjen e rëndë të arsimit tonë në ato vite. Po ashtu z.Fred Van Leeuwen dhe z.Walter Dresscher, kishin bërë shumë angazhime dhe SBASHK-u ishte pranuar që në vitin 1996 si anëtare me të drejta të barabarta në Internacionalen Botërore të Arsimit. Këta dy miq të Kosovës kanë vazhduar me angazhimet për të ndihmuar arsimin e Kosovës dhe me angazhimin e drejtpërdrejtë të tyre në ditët e para të pasluftës në Kosovë janë renovuar e ndërtuar 52 objekte shkollore.

Sekretari i Përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, z. Fred Van Leeuwen dhe z.Walter Dresscher nënkryetar i ETUCE dhe kryetar i AOB-së (Sindikatës së Arsimit të Holandës, do të kenë takime pune me kryetarin e SBASHK-ut,

Rrahman Jasharaj për t'u njoftuar nga afër me arritjet dhe sfidat e kësaj sindikate dhe për të parë mundësitë e përkrahjes së EI-së dhe AOB-së në të ardhmen.



SBASHK-u takua me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kërkohej që Ligjet e aprovuara të zbatohen



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i kishte dërguar më 18 maj një shkresë kryetares

Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, znj. Flora Brovina, me kërkesën që të mbahej një takim i këtij Komisioni për të debatuar e marrë qëndrime lidhur me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe veçmas për pikën 6 të nenit 8 të këtij ligji.

Komisioni ka mbajtur takimin më 27 maj dhe në punimet e tij kanë marrë pjesë edhe kryetari Jasharaj bashkë me menaxherin Ymer Ymeri dhe asistenten në SBASHK, znj. Vlora Rexhepi – Berisha. Delegacioni i SBASHK-ut është shprehur para anëtarëve të këtij Komisioni,

që janë edhe deputet në Parlamentin e Kosovës, nga të gjitha subjektet politike, se në emër të anëtarësisë kërkojmë nga të zgjedhurit e popullit që të kenë një takim me Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ,z. Arban Abrashi, dhe të kërkojnë që Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti të implementohet në tërësi, pra edhe pika 6 e nenit 8 që të implementohet në tërësi, pra edhe pika 6 e nenit 8 që e thotë qartazi se : “Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”.

Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe të gjithë diskutuesit janë shprehur në favor të kësaj kërkesë duke deklaruar se pikërisht në vitet 1989-1999



mësimdhënësit e Kosovës kanë dhënë kontribut të lartë në shërbim të arsimit dhe shtetësisë së Kosovës.

Ata kanë premtuar se do të takohen me ministrin Abrashi dhe këtë kërkesë të SBASHK-ut do ta debatojnë edhe me kolegët e tyre deputetë me qëllim që ky ligj në tërësi të jetë shtetë dhe që mësimdhënësit e Kosovës ta gëzojnë pensionin e punës.

Këshilli Shtetëror për Licencim në shërbim të cilësisë në arsim

U debatua lidhur me licencimin dhe performancën e gradimin

Këshilli Shtetëror për Licencim, anëtar i të cilit është edhe Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, në takimin e rregullt të këtij organi të lartë arsimor, kanë biseduar për Planin e punës së Këshillit për vitin 2015 duke insistuar që ky plan të realizohet në tërësi dhe të ketë angazhime e arritje të reja. Po në këtë takim është debatuar lidhur me dy dokumente të draftuara e që kanë të bëjnë me profilin e kompetencave të mësimdhënësve të Arsimit parauniversitar dhe për Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e performancës.

Me qëllim që këto dokumente të jenë sa më të plota dhe sa më funksionale janë formuar grupe punuese nga anëtarët e Këshillit Shtetëror të cilët do të analizojnë me përpikëri përmbajtjen

e këtyre dokumenteve të draftuara dhe pastaj do të japin propozime konkrete që këto dokumente të jenë sa më të plota e funksionale.

Edhe në këtë takim kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, është shprehur kundër disa individëve, kushdo qofshin ata, që po japin vlerësime se gjoja është i ulët niveli i cilësisë në arsimin tonë. Ai e ka kundërshtuar këtë vlerësim me plot argumente duke deklaruar se pjesa dërmuese e mësimdhënësve angazhohen me tërë mundësitë e tyre në shërbim të arsimit dhe edukimit të brezave dhe ka kërkuar që shteti të ndaj më shumë buxhet për arsimin në mënyrë që të krijohen mundësi e kushte në shkollat tona për arritje edhe më të mëdha.

Përfaqësuesja e lartë e GIZ vizitoi Sindikatën tonë

Ndërkombëtarët shprehin respekt të lartë për angazhimet e SBASHK-ut

Duke parë angazhimin e singertë e të fuqishëm të SBASHK-ut në shërbim të të anëtarësisë dhe të arsimit në Kosovë, menaxherja e Programit

CDBE/GIZ , znj. Dagmar Fuchs – Shmitz, e shoqëruar nga znj. Linda Ukimeraj, koordinatore e Edukimit Bazik të Kosovës, kanë vizituar selinë

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





e SBASHK-ut dhe janë takuar me kryetarin Rahman Jasharaj dhe stafin e SBASHK-ut. Menaxherja e GIZ, znj. Shmitz ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe pastaj ka dhënë hollësi nga aktivitetet e GIZ, që ka për qëllim angazhimet për të qenë pranë mësimdhënësve në përpjekje për të ngritur cilësinë në arsim. Përfaqësueset e GIZ, znj. Shmitz dhe Ukimeraj kanë dëgjuar me vëmendje

për angazhimet dhe aktivitetet e planifikuara për të ardhmen nga SBASHK-u dhe pastaj kanë apeluar që të shtohet bashkëpunimi.

„GIZ ka njohur të shumta për aktivitetet dhe angazhimet e SBASHK-ut. Ne e dimë që keni unitet të shkëlqyer dhe se komunikoni nga afër me mësimdhënësit dhe prandaj kërkojmë që SBASHK-u të vazhdojë me angazhimet me anëtarët e shumtë të tij për të shtuar edhe më cilësinë në arsimin e Kosovës“, është shprehur znj. Dagmar Fuchs – Shmitz. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj bashkë me menaxherin Ymer Ymeri dhe asistenten Vlora Rexhepi-Berisha, kanë shprehur respekt për gjithë angazhimet e GIZ –it në Kosovë dhe u kanë deklaruar mysafireve se SBASHK-u do të jetë gjithmonë i përkushtuar në shërbim të anëtarësisë dhe të arsimit në Kosovë dhe se këtë e ka dëshmuar në të kaluarën dhe po e dëshmon edhe sot e gjithmonë.

Takimet informative me anëtarët e SBASHK-ut nëpër Komunat e Kosovës

Përkrahet angazhimi i SBASHK-ut për shërbime të reja ndaj anëtarësisë



Në kuadër të projektit **“Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave Arsimore”**, po zhvillohen takime informative me anëtarët e SBASHK-ut nëpër Komunat e Kosovës. Takimet informative me mësimdhënësit filluan nga komuna e Mitrovicës dhe vazhduan në këto komuna : Vushtri, Skenderaj, Drenas, Obiliq, Klinë, Istog, Deçan, Junik, Pejë, Malishevë, Gjakovë, Rahovec, Gjilan, Kamenicë, Ferizaj, Viti, Prizren.

Të gjitha këto takime janë udhëhequr nga kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj dhe anëtarët tjerë të Kryesisë që janë ndihmuar nga kryetarët e niveleve komunale. Të pranishmit në

bashkëbisedë me kryetarin e SBASHK-ut kanë debatuar për çështje të rëndësishme. Ata kanë përgëzuar SBASHK-un për arritjet dhe janë



shprehur se uniteti i krijuar është forca më e madhe e SBASHK-ut. Në këto takime është folur edhe për licencimin dhe mbrojtjen juridike të anëtarëve të SBASHK-ut. Për këto çështje sqarime kanë dhënë koordinatori Albina Arifi dhe juristi Blendor Shatri. E veçanta e këtyre takimeve ishte edhe prezantimi i më shumë se 100 marrëveshjeve që SBASHK-u ka nënshkruar me bizneset private dhe institucionet shëndetësore dhe rekreative në Kosovë dhe



Shqipëri. Të pranishmit janë shprehur se janë duke përdorë kartelat e tyre dhe janë duke gëzuar frytet e këtyre marrëveshjeve. Ata kanë propozuar që të vazhdohet me takimet në formë bashkëbisede me anëtarësinë edhe në të ardhmen dhe kreu i SBASHK-ut ka shprehur gatishmërinë që kjo të ndodhë. Pyetjet më të shpeshta ishin lidhur me stazhin e viteve '90-'99, për shkakun pse nuk merren tri paga me rastin e pensionimit të të punësuarve në arsim edhe pse kjo parashihet edhe me ligj dhe me Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar . Ka pasur edhe kërkesa lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kushtet , orarin dhe natyrën e veçantë të punës në çerdhe e po ashtu është kërkuar

angazhim i SBASHK-ut që të ndikojë të organet qeveritare që të nxirret një ligj që do të ofronte zgjidhje të drejtë e humane për mësimdhënësit që punojnë edhe pse janë të sëmurë. Përveç informimit për procesin e Licencimit dhe Rregullores për shërbime juridike falas, mësimdhënësit janë informuar edhe për ueb-faqen e SBASHK-ut www.sbashk-rks.org, faqe kjo që sjell informacione për çdo aktivitet të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë . Aty janë të publikuara edhe të gjitha marrëveshjet për zbritje çmimesh me firmat e ndryshme nëpër Kosovë si dhe në bregdetin shqiptar, si dhe për rubrikën pyetje/përgjigje ku mund t'i adresojnë problemet e tyre. Këto takime të nevojshme tashme për mësimdhënësit do të vazhdojnë edhe nëpër komunat tjera në ditët në vazhdim.



SBASHK-u vazhdon traditën

370 punonjës të arsimit do të pushojnë në bregdetin shqiptar

Edhe këtë vit, SBASHK-u vazhdon traditën duke i



dërguar punonjësit e arsimit në pushime në bregdetin shqiptar.

Kësaj radhe numri i pushuesve arrin në 370, falë fondit për pushime dhe rekreacion. Përzgjedhja e pushuesve si cdo herë tjetër bëhet në bazë të

disa kriterëve, te jete anëtare i SBASHK-ut, te jete zgjedhur nga shoqata sindikale etj.

Numri i pushuesve sipas komunave është nda ne baze të numrit të anëtarësisë që k një komunë ku në çdo 58 anëtarë, shkon në pushim një përfaqësues. Se sa është numri sipas komunave mund te shihet ne tabelën e mëposhtme.

Te Martën me datën 26.05.2015 Komisioni Qendror dhe ai Regjional për përgatitjen e procedurave dhe aneve teknike për pushim si dhe shoqërimin e pushuesve ne bregdet ka mbajtur mbledhjen dhe ka diskutuar për format sa me te mira për pushuesit gjithashtu ka konstatuar edhe pse afati për dozimin e listave ka skaduar disa komuna ende si kanë sjell listat siç janë: Gjakova, Drenasi, Prizreni, Kamenica dhe

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Podujevë. Gjithashtu u konstatua se shumica e komunave nuk ju kanë përmbajtur numrit sipas gjinisë që ishte caktuar nga KD i SBASHK-ut.

Komisioni regional të njëjtën ditë zgjodhi edhe vendin hotelin ku do të pushojnë këta pushues në mesin e tri ofertave zgjodhi ofertën me të lirë të Hotel Bonitës në Durrës Nisja do të bëhet me datë 22 qershor deri me 27 qershor dhe nisja do të bëhet nga secila komunë ku për orarin e nisjes do të njoftohen me kohë .

Listat me emrat e pushuesve të caktuar nga Shoqatat Sindikale posa të kompletohen do të

publikohen në ueb faqen e SBASHK-ut www.sbashk-rks.org

Si cdo vit tjetër edhe kësaj radhe besojmë se të gjithë pushuesit do të kenë mundësi të njihen me njëri-tjetrin, të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të kënaqen me bukuritë e bregdetit shqiptar, ku edhe do të kenë mundësinë që përshtypjet e tyre t'i shprehin përmes librit të përshtypjeve që SBASHK-u posedon.

Urojmë që të kaloni mirë ju anëtarë të SBASHK-ut.

Pushim të këndshëm!

Ndarja sipas Komunave për pushim për vitin 2015

Nr	Komuna/Institucioni	Nr. Total 2015	Anëtarësia sipas Prill	Meshkuj	Femra	Nr.Total për pushim
1	Deçan	601	504	6	3	9
2	Dragash	514	136	2		2
3	Ferizaj	1841	1626	18	10	28
4	Fushë Kosova	430	172	2	1	3
5	Gjakova	1573	1348	15	8	23
6	Gjilani	1820	1241	14	7	21
7	Glogovc	940	806	9	5	14
8	Hani i Elezit	120	114	1	1	2
9	Istogu	653	433	5	2	7
10	Juniku	63	61	1		1
11	Kaçaniku	550	480	5	3	8
12	Kamenica	787	564	7	3	10
13	Klina	644	619	7	4	11
14	Klllokoti	54	17	1		1
15	Leposaviqi	329	15	1		1
16	Lipjani	1049	763	8	5	13
17	Malisheva	1060	629	7	4	11
18	Mitrovica	1269	1026	12	6	18
19	Novoberda	177	20	1		1
20	Obiliqi	390	331	4	2	6
21	Peja	1508	1362	15	8	23
22	Podujeva	1358	585	7	3	10
23	Prishtina	3142	1056	12	6	18
24	Prizreni	2447	1537	18	9	27
25	Rahoveci	839	709	8	4	12
26	Shtimja	464	330	4	2	6
27	Shterrpc	266	18	1		1
28	Skenderaj	981	679	8	4	12
29	Suhareka	970	841	10	5	15
30	Vitja	788	724	8	4	12
31	Vushtrria	1109	938	11	5	16
32	Zveçani	167	19	1		1
33	Qendra e Studentve	230	117	1	1	2
34	Universiteti	2230	541	6	3	9
35	Bibloteka	855	65	1		1
36	Muzeu	25	17	1		1
37	Shoqërisit nga Regjionet	25	17	5	3	8
38	Komisioni Qendror			3	2	5
		32,243	20,443	246	123	369

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsime dhe Kulturë

KEC

